



**Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo**  
**Institucioni i Avokatit të Popullit • Instancija Ombudsmana • Ombudsperson Institution**

Prishtinë, më 31 korrik 2019

Znj. Adrijana Hodžić, Ministre  
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal  
Ish-ndërtesa Rilindja  
10000 Prishtinë

## LETËR REKOMANDIM

Ankesa nr. 9/2019

**Cengiz Kovaç**  
**kundër**

**Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal**

E nderuara znj. Hoxhiq,

Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP), në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, më 18 dhjetor 2018, ka pranuar ankesë nga z. Cengiz Kovaç parashtruar kundër Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) lidhur me Udhëzimin Administrativ MAPL nr. 2014/01 për Procedurën e Emërimit të Nënkyetarëve në Komuna (në tekstin e mëtejme *UA nr. 2014/01*).

Sipas pretendimeve të ankuesit, dispozitat e UA nr. 2014/01 nuk janë në harmoni me dispozitat kushtetuese, konkretisht me nenin 62 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe, si rezultat i kësaj, atyre po u mohohet e drejta e përfaqësimit, e garantuar me Kushtetutë.

Avokati i Popullit vëren se Ligji nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neni 61 [Nënkyetari i Komunës për Komunitete], (paragrafët 1 dhe 3), përcakton:

1. *“Komunat ku të paktën 10% e qytetarëve i përkasin komuniteteve jo shumicë do të kenë një nënkyetar për komunitete.”*
- 3 *“Emërimi dhe shkarkimi i Nënkyetarit për Komunitete propozohet nga Kryetari i Komunës dhe duhet të miratohet nga shumica e anëtarëve të Kuvendit të Komunës që janë të pranishëm dhe votojnë si dhe shumica e anëtarëve të Kuvendit të Komunës që janë të pranishëm dhe votojnë të cilët i përkasin komuniteteve jo shumicë.”*

Avokati i Popullit më tej vëren se UA nr. 2014/01, neni 4 [Procedura për emërimin e nënkyetarit të komunës për komunitete], (paragrafët 1 dhe 3), përcakton:

1. *“Në komunat ku së paku 10% e qytetarëve i përkasin komunitetit jo shumicë, emërimi i nënkryetarit të komunës për komunitete nga radhët e komuniteteve jo shumicë është i obliguar.”*
- 3 *“Nënkryetari i komunës për komunitete nga radhët e komuniteteve jo shumicë propozohet nga Kryetari i Komunës dhe emërohet me vendim të Kuvendit të Komunës, nga shumica e anëtarëve që janë të pranishëm dhe votojnë, si dhe shumica e anëtarëve të Kuvendit të Komunës që janë të pranishëm dhe votojnë, të cilët i përkasin komuniteteve jo shumicë.”*

Ndërsa neni 6 [Kushtet për emërimin e nënkryetarëve], paragrafi 2, i UA nr. 2014/01 përcakton:

*“Nënkryetari i komunës për komunitete emërohet nga radhët e komunitetit jo shumicë, i cili për nga numri përbën komunitetin jo shumicë më të madh në Komunë.”*

Bazuar në këtë që u theksua më sipër, Avokati i Popullit vëren se Ligji nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ua ka njohur komuniteteve të drejtën që ta kenë një nënkryetar komune për komunitete nëse të paktën 10 për qind e qytetarëve të asaj komune u përkasin komuniteteve jo shumicë. Sipas këtij përcaktimi, ligji nuk bën ndarjen e komuniteteve jo shumicë, mirëpo e përcakton atë si tërësi, e cila duhet të jetë jo më pak se 10 për qind e të gjithë qytetarëve të një komune.

Avokati i Popullit vëren se fryma e dispozitave të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, deri diku, është bartur edhe tek UA nr. 2014/01, tek e drejta e pjesëtarëve të komuniteteve jo shumicë që ta kenë një nënkryetar komune për komunitete, nëse të paktën 10 për qind e qytetarëve të asaj komune i përkasin komuniteteve jo shumicë.

Mirëpo, neni 6, paragrafi 2, i UA nr. 2014/01 duket se, komuniteteve jo shumicë që nuk e përbëjnë komunitetin më të madh jo shumicë, ua mohon që ta kenë nënkryetarin për komunitete nga radhët e veta. Si rrjedhojë e kësaj, Avokati i Popullit konsideron se neni 6, paragrafi 2, i UA nr. 2014/01 nuk është në harmoni me Ligjin nr. 04/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe se i njëjti duhet të ndryshohet.

Avokati i Popullit vëren se Ligji nr. 04/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale i ka paraqitur komunitetet jo shumicë si tërësi, sepse shprehimisht e ka përcaktuar se numri i tyre duhet të jetë së paku 10 për qind e qytetarëve të një komune.

Në këtë drejtim, Avokati i Popullit konstaton se çfarëdo kufizimi në Udhëzimin Administrativ, sipas të cilit do t'i jepej përparësi ndonjërit nga komunitetet jo shumicë për propozimin e nënkryetarit të komunës për komunitete, e cenon të drejtën e komuniteteve të tjera jo shumicë që nuk janë komuniteti më i madh jo shumicë, që ta propozojnë nënkryetarin e komunës për komunitete.

Gjatë analizimit të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, përkatësisht neni 61, paragrafët 1 dhe 3, Avokati i Popullit ka vërejtur mospërputhje në të njëjtin version në mes gjuhës shqipe dhe gjuhës serbe, e cila në praktikë mund të sjell paqartësi rreth zbatimit të këtyre akteve.

Po ashtu, Avokati i Popullit ka vërejtur mospërputhje në mes gjuhës shqipe dhe gjuhës serbe në të njëjtin version edhe në Udhëzimin Administrativ MAPL nr. 2014/01 për Procedurën e Emërimit të Nënkyetarëve në Komuna, përkatësisht neni 4, paragrafët 1 dhe 3.

Avokati i Popullit tërheq vëmendjen, se është e domosdoshme të ndërmerren hapa konkrete lidhur me harmonizimin gjuhësor të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe Udhëzimit Administrativ MAPL nr. 2014/01 për Procedurën e Emërimit të Nënkyetarëve në Komuna, në mënyrë që përcaktimet e mësipërme ta kenë të njëjtin kuptim në të dy versionet gjuhësore.

Përfundimisht, Avokati i Popullit thekson se qytetarëve të komuniteteve jo shumicë duhet t'u mundësohet që, lirshëm dhe me marrëveshje ndërmjet tyre, të vendosin rreth propozimit të kandidatit për nënkryetar të komunës për komunitete, pa pasur ndonjë kufizim të caktuar në Udhëzimin Administrativ, i cili bie në kundërshtim me dispozitat e Ligjit nr. 04/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale. Po ashtu, Avokati i Popullit konsideron se përcaktimet ligjore dhe nënligjore duhet ta kenë të njëjtin kuptim gjuhësor në të gjitha gjuhët zyrtare që përdoren në Republikën e Kosovës.

Rrjedhimisht, Avokati i Popullit i:

## **REKOMANDON**

### **Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal**

- 1. Ta bëjë ndryshimin e Udhëzimit Administrativ MAPL nr. 2014/01 për Procedurën e Emërimit të Nënkyetarëve në Komuna, përkatësisht ta fshijë paragrafin 2 të nenit 6.*
- 2. Në bashkëpunim me Kuvendin e Republikës së Kosovës, të ndërmarrin veprime konkrete, me qëllim të harmonizimit gjuhësor të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, përkatësisht ta bëjnë harmonizimin gjuhësor të nenit 61, paragrafët 1 dhe 3.*
- 3. Të ndërmerr masa konkrete me qëllim të harmonizimit gjuhësor të Udhëzimit Administrativ MAPL nr. 2014/01 për Procedurën e Emërimit të Nënkyetarëve në Komuna, përkatësisht ta bëjë harmonizimin gjuhësor të nenit 4, paragrafët 1 dhe 3.*

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ("Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'ia paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj") dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit ("Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, (...) duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim

*për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), ju lutemi që të na informoni për veprimet që do t’i ndërmerrni lidhur me këtë çështje.*

Me nderime,

  
Hilmi Jashari

Avokat i Popullit